2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 te LPP dhe nenin 75 te VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 7. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Gazoili të jetë D1 i shoqëruar me çertifikatën e cilësisë së mallit sa herë që kërkohen nga Autoriteti Kontraktor.

Cilësia e gazoilit D1 duhet të jetë konform standarteve të miratuara shtetërore, e konform tabelës me parametrat e përcaktuara.

Furnizimi për automjetet e Autoritetit Kontraktor, do të behet me kartën elektronike (me të cilat Furnizuesi do të pajisë Autoritetit Kontraktor, sipas kërkesës së këtij të fundit).

Furnizuesi do të ofrojë shërbim për furnizimin e Autoritetit Kontraktor të paktën në një ose më shumë pika furnizimi ne territorin e Qytetit Elbasan.

Specifikimet teknike te mallit objekt prokurimi do të jenë:

Specifikimi i Materialeve: Për të dyja lotet.

Loti 1 :GAZOIL D1 te jete me parametrat e meposhtem sipas standartit SSH EN 590:2013

Jane të pranueshme standarte të barasvlefshme me standartet e sipërpërmendur.

Nr	Treguesit	Njesia	Kufijte
1	Densiteti ne 15°C	Kg/l	0.820-0.845
2	Indeksi I Cetanit		Min 51
3	Pika e flakerimit	°C	Min 55°

4	Permbajtja e H ₂ O	Mg/kg	Max 200
5	Permbajtja e sqfurit	%Wt	Max 0.350
6	Viskoziteti ne 40°C	Mm ² /s	2.5 – 4.5
7	Stabiliteti I oksidimit (djegies)	g/m ³	Max 25
8	Hidrokarbure polic-aromatik	% (m/m)	Max 1.1

Loti 2; BENZINA TE JETE PA PLUMB me parametrat e meposhtem sipas standartit S SHEN 228:2012

Jane të pranueshme standarte të barasvlefshme me standartet e sipërpërmendur.

Nr	Treguesit	Njesia	Kufijte
	Numri I Oktaneve	-	Min. 95.0
1	Permbajtja e plumbit	Mg/l	0
2	Densiteti ne 15°C	Kg/m ³	Min 720 – max 775
3	Permbajtja e sulfurit	Mg/kg	Max 10
5	Stabiliteti I oksidimit	minuta	Min = 360
6	Korrozioni I shiritit te bakrit (3ore ne 50°C)	E paster dhe e kthjellet	
7	Permbajtja e tipeve te hidrokarbureve - Olefins - aromatike	%(V/V)	Max 18 Max 35
8	Permbajtja e Benzene	%(V/V)	Max 1.0

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- a. Të dhënat teknike të karburanteve të jenë sipas standarteve të përcaktuara nga Komuniteti European.

-
- b. Shoqëria fituese e procedurës të sigurojë furnizim me karta elektronike të cilat të mundësojnë identifikimin e targës së makinave dhe përdoruesin e saj.
 - c. Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e normës së fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet/entet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, në çmimin e bursës të publikuar në Buletinin e Njoftimeve publike, i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, levruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment.
 - d. Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit do të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, të publikuar në Buletinin e Njoftimeve publike, i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, levruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në momentin e shitjes së mallit, objekt kontrate, autoriteteve kontraktore, si dhe çelësine e mallit të levruar, nëse është e nevojshme me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e pritshme e mallit, mbi bazen e te ciles eshte perlogaritur fondi limit, eshte:

* Loti 1	GAZOIL D1	LITRA	63250
-----------------	------------------	-------	-------

Sasia e pritshme e mallit që kërkohet sipas kontrates:

Sasia e karburantit që do levrohet do te percaktohet ne baze te çmimit, i cili do te rezultoje pas lidhjes se kontrates, sipas publikimeve zyrtare te APP, duke mbajtur fiks vetem marzhin e fitimit ne vlere absolute, te percaktuar ne oferten e paraqitur ne tender, nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

Afatet e levrimit:

Afati i levrimit do te jete 12 muaj nga data e nenshkrimi te kontrates sipas kerkesave te AK.

Menyra e levrimit.

Ne zbatim te VKM Nr.561, datë 29.7.2016 "Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit do të kryhet vetëm nëpërmjet **kartës elektronike** me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj.

Karburanti (Gazoil D1) do te levrohet me ndihmen e kartave elektronike, qe do te jene personale per çdo automjet dhe qe do te prodhohen dhe do te vihen ne dispozicion te autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik qe do shpallet fitues. Kartat elektronike do te kene vlere, pra do te jene te perdorshme ne distributorin/distributoret e kontraktuesit gjate te gjithe kohes se ekzekutimit te kontrates.

Operatori ekonomik kontraktues duhet të sigurojë furnizim të vazhdueshëm për 24 orë në ditë dhe sipas cilësisë së përcaktuar në dokumentat e tenderit në pikën/në të gjitha pikat e shpërndarjes se karburantit qe ai ka vene ne dispozicion te kesaj kontrate.

Likuidimi i mallit, do te behet sipas sasise mujore te konsumuar nga Autoriteti Kontraktor, ku te percaktohet sasia, njesia, çmimi dhe shuma e mallit te konsumuar.

Karburantet e kërkuara për furnizim me ane te kartave do te levrohen sipas targave te automjeteve, per te cilat jane prodhuar keto karta te personalizuara. Furnizimi do të kryhet kundrejt paraqitjes së kartave (te personalizuara).

Operatori ekonomik pranon levrimitin e mallit me kriteret e levrimit si me siper:

OPERATORI EKONOMIK

Sasia e pritshme e mallit, mbi bazen e te ciles eshte perlogaritur fondi limit, eshte:

Loti 2.	BENZINE PA PLUMB	LITRA	2970
----------------	-------------------------	--------------	-------------

Sasia e pritshme e mallit që kërkohet sipas kontrates:

Sasia e karburantit që do levrohet do te percaktohet ne baze te çmimit, i cili do te rezultoje pas lidhjes se kontrates, sipas publikimeve zyrtare te APP, duke mbajtur fiks vetem marzhin e fitimit ne vlere absolute, te percaktuar ne oferten e paraqitur ne tender, nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

Afatet e levrimit:

Afati i levrimit do te jete 12 muaj nga data e nenshkrimi te kontrates.

Menyra e levrimit.

Ne zbatim te VKM Nr.561, datë 29.7.2016 “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit do të kryhet vetëm nëpërmjet **kartës elektronike** me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj.

Karburanti (Benzine pa plumb) do te levrohet me ndihmen e kartave elektronike, qe do te jene personale per çdo automjet dhe qe do te prodhohen dhe do te vihen ne dispozicion te autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik qe do shpallet fitues. Kartat elektronike do te kene vlere, pra do

te jene te perdorshme ne distributorin/distributoret e kontraktuesit gjate te gjithë kohes se ekzekutimit te kontrates.

Operatori ekonomik kontraktues duhet të sigurojë furnizim të vazhdueshëm për 24 orë në ditë dhe sipas cilësisë së përcaktuar në dokumentat e tenderit në pikën/në të gjitha pikat e shperndarjes se karburantit qe ai ka vene ne dispozicion te kesaj kontrate.

Likuidimi i mallit, do te behet sipas sasise mujore te konsumuar nga Autoriteti Kontraktor, ku te percaktohet sasia, njesia, çmimi dhe shuma e mallit te konsumuar.

Karburantet e kërkuara për furnizim me ane te kartave do te levrohen sipas targave te automjeteve, per te cilat jane prodhuar keto karta te personalizuara. Furnizimi do të kryhet kundrejt paraqitjes së kartave (te personalizuara).

Operatori ekonomik pranon levrimin e mallit me kriteret e levrimit si me siper:

OPERATORI EKONOMIK

Loti 1

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT LOTI 1

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e ofertes,*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.1.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë Licence të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), për ushtrim aktiviteti (Tregëtim karburantesh). Operatori Ekonomik të deklarojë se është i regjistruar në QKB dhe ka fushën e veprimtarisë së objektit të prokurimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiroja mesatare vjetore e realizuar gjatë 3(tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, duhet të ketë një vlerë **jo më të vogël se fondi limit që prokurohet, duke iu referuar vlerës së lotit përkatës / shumatores së loteve për të cilat konkurron**”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit ,të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar",

i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.2.3 Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

2.2.4 Vërtetim për shlyerjen e të gjitha taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021 vendet ku operatori ushtron aktivitet sipas QKB.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

2.3.5 Vërtetim lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve për shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi, ku operatori ushtron aktivitet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Furnizime të ngjashme për një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit **duke iu referuar vlerës së lotit përkatës / shumatores së loteve për të cilat konkurron**

Për plotësimin e këtij kriteri OE duhet të paraqesë:

- Në rast se furnizimet janë kryer me ente publike: Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon kontratën dhe vërtetimin realizimi të lëshuara nga një ENT publik për realizimin e kontratës, ku të shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave.

- Në rast se furnizimet janë kryer me sektorin privat: Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon fatura tatimore shitje, ku të shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave.

2.3.2 Operatori duhet të ketë **1 (një) pikë** shpërndarje të karburantit NE PRONESI ose NE PERDORIM ME MARREVESHJE me pikë/pika shpërndarje brenda territorit të Qytetit Elbasan (brenda juridiksionit territorial të 6 rajoneve të qytetit Elbasan, pa përfshirë ish komunat), për të mos shkaktuar konsum të tepert karburanti të panevojshëm nga automjetet e autoritetit kontraktor. Marrëveshja/marrëveshjet duhet të jete jete hartuar me akt-noterial me pronarin dhe të ketë specifikuar adresën e saktë të pikës së shpërndarjes së karburantit.

2.3.3 Autorizim për tregtimin e karburanteve/lëndëve djegëse lëshuar nga pushteti vendor, sipas Ligjit Nr.8450 dt.24.02.1999 "Për përpunimin, transportin dhe tregtimin të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", me ndryshimet.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Fletë analizë ose raport analizë i cilësisë së karburantit, lëshuar nga ISHTI, lëshuar jo më heret se 30 ditë nga dita e hapjes së ofertës.

Specifikimet teknike (Shtojca nr.9), e miratuar nga operatori ekonomik (e firmosur dhe e vulosur).

Grafiku i Lëvrimet (Shtojca nr.10), e miratuar nga operatori ekonomik (e firmosur dhe e vulosur).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT :LOTI 2

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e ofertes,*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit.

2.1.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë Licence të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), për ushtrim aktiviteti (Tregëtim karburantesh). Operatori Ekonomik të deklarojë se është i regjistruar në QKB dhe ka fushën e veprimtarisë së objektit të prokurimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhironja mesatare vjetore e realizuar gjatë 3(tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, duhet të ketë një vlerë **jo më të vogël se fondit limit që prokurohet, duke iu referuar vlerës së lotit përkatës / shumatores së loteve për të cilat konkurron**".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit ,të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezultojnë se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

2.2.4 Vërtetim për shlyerjen e të gjitha taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021 vendet ku operatori ushtron aktivitetet sipas QKB.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik,çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

2.3.5 Vërtetim lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve për shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi, ku operatori ushtron aktivitetet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Furnizime të ngjashme për një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit **duke iu referuar vlerës së lotit përkatës / shumatores së loteve për të cilat konkurron**”

Për plotësimin e këtij kriteri OE duhet të paraqesë:

-Ne rast se furnizimet janë kryer me ente publike: Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon kontratën dhe vërtetimin e realizimit të lëshuara nga një ENT publik për realizimin e kontratës, ku të shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave.

-Ne rast se furnizimet janë kryer me sektorin privat: Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon faktura tatimore shitje, ku të shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave.

2.3.2 Operatori duhet të ketë **1 (një) pikë** shpërndarje të karburantit NE PRONESI ose NE PERDORIM ME MARREVESHJE me pikë/pika shpërndarje brenda territorit të Qytetit Elbasan (brenda juridiksionit territorial të 6 rajoneve të qytetit Elbasan, pa përfshirë ish komunat), për të mos shkaktuar konsum të tepert karburanti të panevojshëm nga automjetet e autoritetit kontraktor. Marrëveshja/marrëveshjet duhet të jetë jete hartuar me akt-noterial me pronarin dhe të ketë specifikuar adresën e saktë të pikës së shpërndarjes së karburantit.

2.3.3 Autorizim për tregtimin e karburanteve/lëndëve djegëse lëshuar nga pushteti vendor, sipas Ligjit Nr.8450 dt.24.02.1999 "Për përpunimin, transportin dhe tregtimin të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", me ndryshimet.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Fletë analizë ose raport analizë të cilësisë së karburantit, lëshuar nga ISHTI, lëshuar jo më heret se 30 ditë nga dita e hapjes së ofertës.

Specifikimet teknike (Shtojca nr.9), e miratuar nga operatori ekonomik (e firmosur dhe e vulosur).

Grafiku i Lëvrimin (Shtojca nr.10), e miratuar nga operatori ekonomik (e firmosur dhe e vulosur).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I.Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
<ul style="list-style-type: none">Informacione për nënkontraktorin			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar
<ul style="list-style-type: none">Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik			

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese,	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni]

<p>vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p>	<p>_____</p>
<p>1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklaratë;</p>	<p>Po []</p>
<p>2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;</p>	<p>Po []</p>

<p>3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;</p>	<p>Po []</p>
<p>4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</p>	<p>Po []</p>
<p>5. Për efekt të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:</p> <p>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;</p> <p>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .</p>	<p>Po []</p>
<p>6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).</p>	<p>Po [] Jo []</p>
